

# **KONCESIONE / PARTNERITET** **PUBLIK PRIVAT**

## **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË** **NJOFTIM ANULLIMI**

Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktues: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, Tiranë.

Lloji i Autoritetit Kontraktues: Institucion Qendror

Forma, Objekti dhe Lloji i Kontratës: Forma: Koncesion; Objekti: Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim dhe transferim i segmentit rrugor “Milot-Balldre” dhe Lloji i Kontratës “Punë”

Lloji i procedurës: E hapur

Numri i Referencës së procedurës: REF – 33965-12-18-2024

Kohëzgjatja e Kontratës: 35 (tridhjetë e pesë) vjet

Vlera totale e parashikuar e Kontratës: 364’732’924 (treqindegjashtëdhjetekatër milion e shtatëqindetridhjetedy mijë e nëntëqindnjëzetekatër) EUR pa TVSH.

Vendndodhja e objektit të Kontratës: Gjurma e propozuar e rrugës “Milot-Balldre” fillon në nyjen e Milotit, ku do të lidhet me segmentet e tjera rrugore Milot-Thumanë-Kashar-Lekaj dhe me Rrugën e Kombit, dhe do të përfundojë në rrugën ekzistuese Tiranë –Shkodër, në Balldre.

Arsyet e Anulimit: Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbushin kërkesat e ftesës për procedurën konkurruese, pra nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

Informacione shtesë: Ofertuesit janë njoftuar për skalifikimin e tyre nga Autoriteti Kontraktues në datë 19.06.2025.